



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës Bazat e Financave

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Bazat e Financave
Niveli:	Bachelor
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (semestri I)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë studentëve do t'u ofrojë njohuritë themelore mbi teorinë, metodat dhe problemet e financave bashkëkohore, krijimin dhe menaxhimin e parasë dhe asetëve të tjera financiare midis firmave dhe tregjeve financiare me theksim të vecant në instrumentet e tregut të parasë dhe kapitalit, Studentët gjithashtu do të fitojnë njohuri se si firmat krijojnë dhe menaxhojnë në mënyrë efikente asetet e tyre financiare.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor është që studentët të jenë në gjendje të analizojnë vendimet kritike nga një prespektiv financiare. Qëllimi i lëndës gjithashtu është të ofrojë një perspektivë të gjerë se si teoria dhe praktika financiare ndërveprojnë në jetën e vërtetë dhe përgatitjen e studentëve për karrierë të suksesshme në industrinë financiare. Qëllimet kryesor të lëndës janë: 1. Të kuptojmë se si të menaxhojmë burimet financiare 2. Të kuptojmë botën e financave. Çdokush i përfshirë në menaxhimin e një biznesit duhet të ketë të paktën njohuri minimale në fushën e financave; 3. Të prezantojmë konceptet themelore financiare si vlerën në kohë të parasë, vlerësimin e asetëve, rrezikun dhe kthimin, buxhetimin e kapitalit etj.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me përfundimin e kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje : 1. Të kuptojnë parimet themelore të financave

	bashkëkohore . 2. Të kuptojnë se si të krijojnë dhe të menaxhojnë në mënyrë efikente asetet e tyre financiare në tregun financiar; 3. Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e tregut financiar; 4. Të kuptojnë se si ti menaxhojnë rreziqet e ndryshme: si rrezikun e kursit të këmbimit, të normës së kamatës, të Inflacionit 5. Të jenë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikojnë në afarizmin e ndërmarrjeve; 6. Të bëjnë planifikimin financiar afatshkurtër dhe afatgjatë dhe të përpilojnë pro-forma 7. Raportet financiare, duke siguruar kështu një kontakt të afërt me praktikën e ndërmarrjeve;□		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanë të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:			
• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar			
Metodat e vlerësimit:			
• Punimi seminarik dhe prezentimi: 0-20% • Kollokviumi i parë: 0-40%			

	- Kollokviumi i dytë: 0-40% ose - Provimi përfundimtar 0- 80%
Literatura	
Literatura bazë:	1. Herbert B. Mayo – Bazat e Financës. Hyrje në institucionet financiare, investime dhe drejtim. UET Press, 2012
Literatura shtesë:	2. Keown, A.; Martin, J. & Petty, J. (2014). Foundations of Finance: The Logic and Practice of Financial Management. USA: Pearson. 3. Salko, D. (2015) Bazat e financës. Tiranë.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezentimi i syllabusit të lëndës
Java e dytë:	Roli i tregjeve financiare
Java e tretë:	Bankat e investimit
Java e katërt:	Tregjet e letrave me vlerë
Java e pestë:	Ndërmjetësit financiarë
Java e gjashtë:	Banka Qendrore (Rezerva Federale)
Java e shtatë:	Flukset ndërkombëtare të monedhës
Java e tetë:	Kollokviumi i parë
Java e nëntë:	Vlera në kohë e parasë
Java e dhjetë	Rreziku dhe matjet e tij
Java e njëmbëdhjetë:	Analiza e pasqyrave financiare
Java e dymbëdhjetë :	Veçoritë e aksioneve
Java e trembëdhjetë:	Vlerësimi i aksionit
Java e katërbëdhjetë:	Veçoritë e borxhit afatgjatë - obligacionet
Java e pesëmbëdhjetë:	Kollokviumi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.